

Informacion i përgjithshëm në lidhje me punën sociale të shkollës (SSA)

Shumë shkolla në Zvicër, krahas personelit akademik punësojnë edhe punonjës socialë. Jo të gjithë e njohin punën sociale në shkollë. Nganjëherë, profesioni "punë sociale" ngatërrohet me profesione të tjera në fushën shkollore.

Shpesh, puna sociale jepet me shkurtimin "SSA". Si rregull, të gjithë "SSA-të" kanë mbaruar studimin "punë sociale". Ashtu si personeli akademik, ato punojnë në shkollë me klasa, me grupe të vogla nxënësish ose me nxënës individualë. Por nga "SSA-të" mund të marrin konsulencë edhe prindërit dhe personeli akademik.

Punonjësit socialë janë ekspertë për dhënien e konsulencës në situata të vështira. Për shembull, kur fëmijët ngacmohen në shkollë nga të tjerët ose nuk gjejnë lidhje në klasë. Natyrisht që si rregull, kur dikush probleme, i drejtohet mësuesit ose mësueses së klasës. Mirëpo, disa çështje kanë nevojë për diskutim më intensiv, për më shumë kohë dhe shumë përvojë në fushën e konsulencës. Në këto raste, personat e përfshirë shfrytëzojnë me kënaqësi mbështetjen e punës sociale.

Konsulenca është falas dhe me vullnet të lirë. Punonjësit socialë i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit. Ata nuk ua tregojnë të tjerëve gjërat private.

Në disa shkolla, punonjësit socialë japin edhe mësim në lidhje me tema të caktuara. Pas kësaj, nxënësit mësojnë, për shembull, si mund të zhvillohet një frymë e re e ekipit ose si të sillen në internet.

Qëllimi i "SSA-ve" është që, me punën e tyre, të kontribuojnë që të gjithë fëmijët të përjetojnë një kohë shkollore pozitive dhe të suksesshme.

Ky tekst informativ disponohet në gjuhë të ndryshme.